



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për:	Xhafer Gashi, Kryetare e Komunës së Obiliqit Vlora Mjekiqi Kabashi, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Obiliqit
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë
Përmes:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së Jeton Qela, Zv. Sekretar i Përgjithshëm i MAPL-së
Nga:	Besim Myrtezani, Zv. Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorimit të Komunave, MAPL Data: 04.08.2023
Zyrtaret përgjegjës:	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave Nr. 020-134/11 Sanije Dërguti, Zyrtar për monitorim të komunave
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Obiliqit
Lloji i aktit:	Vendimi i Kuvendit të komunës së Obiliqit

I nderuar Kryetar,
E nderuar Kryesuese,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si dhe Rregulloren Nr. 06/2021 për ndryshimplotësimin e Rregullos (QRK) Nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2021 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendimin nr-I-105 për ndryshim dhe plotësim të vendimit nr.-I-19, i dt 04.02.2022 për formimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB) me anëtarin Naim Shabani, Kryetar i ri i Këshillit të Prindërve të Komunës, i emëruar nga Drejtoria e Arsimit me vendimin nr.-X-457, të dt.08.06.2023, në vend të znj. Valbonë Beka

I miratuar më datë: 28.07.2023

I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 03.08.2023

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural **është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.**

Arsyetim

Kuvendi i Komunës së Obiliqit në mbledhjen e mbajtur me datë 28.07.2023, ka miratuar *Vendimin Nr. -I-105*.

MAPL, konstaton së Vendimi Nr.-I-105 për ndryshim dhe plotësim të vendimit nr-I-19, për formimin e KKSB-së i nxjerrë nga Kuvendi i Komunës së Obiliqit është bazuar në nenin 4 të UDHËZIMIT ADMINISTRATIV NR. 03/2012 - MAPL PËR KËSHILLAT KOMUNALE PËR SIGURI NË BASHKËSI

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.